





DEMOKRACIA, ÇELËSI I



MIRËQENIES QYTETARE

JETA NË DEMOKRACI

ALBION (15), FLUTURA (16), ENDRITA (15), RINESA (14), DRILON (15), ENIS (14)



Në këtë artikull, ju mund të lexoni për demokracinë, elementet e saj, ligjet dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në demokraci

Të jesh i lirë do të thotë të shprehësh mendimet e tua lirshëm, kurse të marrësh vendime do të thotë të vendosësh për jetën tënde. Demokracia është formë e qeverisjes, ku të drejtën e vendimmarrjes e ka populli, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me anë të zgjedhjes së përfaqësuesve. Pra, në demokraci ud-



Po ashtu, të gjithë kemi të drejtën e barabartë në qasje publike në vendin ku jetojmë. Pra, barazia nënkupton trajtim të barabartë të të gjithëve përballë ligjit. Ligjet janë rregulla që duhet të respektohen. Jeta jonë do të ishte një kaos i vërtetë po të mos ishin ligjet. Në secilën shoqëri ka mendime të ndryshme dhe kjo shumëllojshmëri e mendimeve ka vlerë të madhe, sidomos në vendet demokratike, ku secili ka të drejtën e shprehjes së mendimit.



hëheq populli. Fjala demokraci, rrjedh nga fjalët greke që „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ do të thotë udhëheqje. Kosova është shtet i pavarur demokratik me sistem parlamentar, sepse në procesin zgjedhor, populli voton kandidatët për deputetë.

Në demokraci të gjithë kemi të drejta të barabarta dhe ato janë: e drejta e shkollimit, e drejta e punës, e drejta e votës, e drejta e familjes, e drejta e strehimit, e drejta e identitetit, e drejta e kujdesit shëndetësor, etj.



Grupi „Të barabartët“



Kuvendi mendon dhe vepron në të mirën e popullit



Ne kemi mirëkuptim dhe tolerancë ndaj njëri-tjetrit



Deputetët janë përfaqësuesit e popullit



Institucionet tona dhe lidhja e tyre në mes vete




Ne flasim lirshëm, sepse jetojmë në demokraci



Të bashkuar shkojmë përpara

PUSHTETI I INSTITUCIONEVE TONA

LAURETA (15), FLUTURA (14), RESUL (15), RREZARTA (15), NDRIQIM (15), ALTRIN (15), EDONIS (15)



Kosova ka disa institucione të rëndësishme, të cilat kanë pushtet dhe njëkohësisht kanë edhe obligime e detyra të shumta

Të dashur lexues, me ju sot do të ndajmë një ngjarje e cila përshkruan funksionimin e shtetit tonë.

Siç e dimë ne jemi qytetarë të një shteti të ri, shteti i cili është ende në hapat e parë të zhvillimit. Por, zgjidhja e çështjes së zhvillimit të një shteti, bëhet përmes punës së palodhshme dhe bashkëpunimit të institucioneve. Në Kosovë kemi institucione të ndryshme të cilat kryejnë funksione të ndryshme. Këto institucione kanë pushtet apo fuqi. Për këtë arsye pushteti në Republikën e Kosovës iu takon tri institucioneve: Pushtetit Legjislativ, Pushtetit Ekzekutiv dhe atij Gjyqësor. Këto degë të pushtetit, edhe pse janë të ndara bashkëpunojnë dhe e plotësojnë njëra-tjetrën. Por, arsyeja pse ndahen këto pushtete është se institucionet të cilat i ushtrojnë këto pushtete kanë detyra dhe punë të

ndryshme. Pushteti Ekzekutiv propozon rreth 95% të projektligjeve në Kuvendin e Kosovës, e këtë pushtet e ka Qeveria. Ajo udhëhiqet nga Kryeministri. Qeveria ngërthen brenda vetes ministri të ndryshme, siç janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, etj.

Atë çka mund të bëjë Ministria e Arsimit është të sigurojë mjete teknike për çdo shkollë, siç janë projektorët, prej të cilëve ne si nxënës mund të përfitojmë shumë. Me anë të këtyre mjeteve, mësimdhënia do të jetë më efektive, sepse temat do të konkretizohen më shumë dhe do të bëhen më atraktive për ne nxënësit. Pushteti Gjyqësor, është pushtet i cili merret me vendosjen e drejtësisë së një shteti, ku personat për të cilët dyshohet se kanë thyer ligjin, do të gjykohen dhe pastaj nëse vërtetohet se kanë thyer ligjin, do të ndëshkohen varësisht nga shkalla e shkeljes.



Grupi „Paqja“




Grupi „Liria“

Pushteti Legjislativ ushtrohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, institucion ky i cili miraton ligje, që harmonizojnë jetën e secilit prej nesh


Kuvendi i Kosovës është institucion, i cili ka një rol shumë të rëndësishëm, sepse pikërisht aty merren vendime të ndryshme. Këto vendime merren për qëllime të mira, që ndikojnë dhe prekin jetërat tona. Demokracia njihet si formë e qeverisjes, ku qytetarëve u jepet e drejta të shprehen lirshëm dhe të vendosin se kë ta zgjedhin si përfaqësues. Këta përfaqësues janë 120 deputetë, të cilët zgjedhen me anë të votave të qytetarëve. Deputetët janë prej komuniteteve të ndryshme, sepse në Kosovë jetojnë qytetarë të etnive të ndryshme. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka disa funksione, që deputetët janë të obliguar t'i kryejnë ato. Këto funksione janë: funksioni legjislativ, funksioni përfaqësues si dhe ai kontrollues.




Gazetarët e Kuvendit



Përgjegjësitë e deputetëve



Betimi i deputetes Rrezartë



KOSOVA VENDOS


FISNIK (15), DJELLZA (15), DHURATA (15), DAUT (15), ALBION (15), SADBERE (15)



Grupi ynë „Lumturia“ ka disa informata të dobishme për të gjithë ju, lexues të nderuar

Vendi ynë Kosova, është në prag të një vendimi të madh. Të gjithë ne si qytetarë të Kosovës, kemi para vetes një derë, që nëse e hapim me kujdes, do të na dërgojë drejt ndryshimit.

Vendimi ynë do ta vulosë të ardhmen e vendit tonë. E kemi fjalën për procesin zgjedhor që ndodh në vendet



demokratike, ku të gjithë personat të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë proces. Gjatë këtij procesi, qytetarët dalin të votojnë dhe i zgjedhin përfaqësuesit e vendit. Meqë këta përfaqësues janë përgjegjës për udhëheqjen e vendit, vendimi që ne marrim për ta votuar një kandidat të caktuar, prek jo vetëm jetën tonë, por atë të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Marrim shembull rrotat e veturës. Kemi dëgjuar të

thuhet se atë rrugë që ndjekin rrotat e para të veturës, po të njëjtën do ta ndjekin edhe ato të fundit. Në rastin tonë është e njëjta gjë. Ato vendime që do të miratohen nga deputetët, duhet të respektohen dhe të zbatohen nga të gjithë njësoj.

Kjo është arsyeja pse 11 qershori i këtij viti, është shumë i rëndësishëm për të gjithë ne. As në këtë datë nuk na ndan feja, gjinia, raca, apo gjendja ekonomike. Të gjithë të bashkuar dalim dhe votojmë.

E rëndësishme po ashtu është se në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve, e ato janë: zgjedhjet komunale, ku i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse, si dhe zgjedhjet qendrore, ku i zgjedhim deputetët.


Pra, zgjedhjet e rregullta ndodhin çdo katër vjet. Vota është e drejtë e jona. Këtë të drejtë duhet ta përdorim për të ndryshuar vendin tonë. Andaj, bëhu edhe ti pjesë e vendimmarrjes. Edhe ne, kur ta arrijmë moshën 18 vjeçare do të jemi pjesë e kësaj vendimmarrjeje.



Votuesit e së ardhmes

Kjo është pjesa e dytë e artikullit tonë. Në këtë pjesë, mund të informoheni më shumë për deputetët

Falë gjërave që i mësuam sot, ne që nga tani do të mendojmë dhe pak a shumë kemi arritur ta kuptojmë, se çfarë kërkojmë nga kandidatët e ndryshëm. Gjithashtu, e dijmë se çfarë kërkojmë nga vetja nëse vendosim të kandidojmë. Po ashtu, mësuam dhe kuptuam rëndësinë që kanë deputetët në jetën tonë. Sipas grupit tonë, janë disa cilësi që kandidatët për deputetë duhet t'i kenë. Këto cilësi që ne i kërkojmë nga një kandidat janë: të jetë i drejtë, të mendojë për të mirën e shtetit, të jetë bujar dhe punëtor. Po të njëjtat cilësi i kërkojmë edhe nga vetja, nëse kandidojmë në të ardhmen që të jemi përfaqësues. Vendimet që i marrin deputetët janë shumë të rëndësishme për ne si qytetarë. Nëse deputetët miratojnë një ligj, ne duhet të zbatojmë atë, sepse pa dyshim që ligjet që votohen në Kuvend do ta përmirësojnë jetën tonë. Pra, lexues të dashur, besojmë se tash e keni kuptuar rëndësinë e procesit zgjedhor dhe të deputetëve.



Gratë sikurse edhe burrat, mund të udhëheqin një vend



Procesi zgjedhor dhe rëndësia që ka për të gjithë ne, është e pakrahasueshme



Ne e dijmë se bashkëpunimi është njëra nga vlerat e demokracisë. Prandaj, çdo herë mendojemi që sa më shumë të bashkëpunojmë dhe të jemi tolerantë ndaj njëri-tjetrit. Kjo është mënyra e vetme se si ne mund ta zhvillojmë edhe më shumë një shoqëri demokratike



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËSTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Naim Frashëri“
Klasa: IX-2
Vendi: Banjë, Malishevë